



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 24 dhjetor 2020, përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e projektbuxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2021 (**Vendimi nr. 153, datë 24.12.2020**)
2. Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge në zonën Qarqet Tiranë dhe Durrës. (**Vendimi nr. 154, datë 24.12.2020**)
3. Çeljen e procedurës për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit programi audioviziv në Qarqet Tiranë-Durrës (allotmenti Tiranë). (**Vendimi nr. 155, datë 24.12.2020**)
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Pelari/A” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Fieri”. (**Vendimi nr. 156, datë 24.12.2020**)
5. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Guri Meko, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Aral”. (**Vendimi nr. 157, datë 24.12.2020**)
6. Dhënien e autorizimit shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Tv 4+”. (**Vendimi nr. 158, datë 24.12.2020**)
7. Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Shpresa Boriçi, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Tërbuf”, duke hequr dorë nga zona “*Njësia administrative Kallmet Lezhë*”. (**Vendimi nr. 159, datë 24.12.2020**)
8. Kalimin e të drejtave të autorizimit të subjektit person fizik Arben Lame, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Tivo Cable”, tek shoqëria “APT Cable” sh.p.k. (**Vendimi nr. 160, datë 24.12.2020**)
9. Miratimin e ndryshimeve të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga shoqëria “Radio Sport” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat “Radio Shqip”, për ndryshimin e emrit të shoqërisë nga “Radio Sport” në “Radio Shqip” sh.p.k. (**Vendimi nr. 161, datë 24.12.2020**)

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 3 anëtarë të AMA-s e ndërprejnë mbledhjen dhe çështjet e mëposhtme:

- Relacion dhe projektvendim “Për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”.
- Diskutim mbi pagesat vjetore për licencë, për vitin 2021, të subjekteve të licencuar për transmetim audio.
- Diskutim mbi mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastër.

Page | 2

për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhen për në mbledhjen e radhës.

## **AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 24 dhjetor 2020**